



SHTËPIA PUBLIKE

(Roman me nëntë plagë)

*Dhe kur të shkosh, moj Dor-e-këmb-argjende
Për të gostitur miqtë n'ato vënde,
Ku pinim bashkë, e t'arrish ku rri,
Mos psherëti! - po zbras-më Kupën tënde...*

Omar KHAJAM

Arratisja nga Qyteti i Qyqeve

Nëntë ditë e nëntë netë po bëhen, që kur kam ikur nga Qyteti i Qyqeve, për ta përfunduar librin e rrezikshëm të të gjitha kohrave Shtëpinë Publike. Nëntë ditë e nëntë netë jam arratisur në një shpellë buzë Liqenit. Larg njerëzve, larg thashethemeve me romanin e "rrezikshëm" në kokë, plot dhjetë vjet me radhë. Nëntë plagë... Plagën e dhjetë e mora në një natë me Hënë të plotë majë një shkëmbi mbi Liqe, në Strugë...

Flakë më flakë te Kisha... Uji i Shenjtë... Tym për tymi me dudumët mes dallgëve...

Lufë kjo, që pas kaq vitesh do të ma kujtojë Babain me "nagëntin" në brez. Kokë më kokë në odën e burrave. Miqtë që e dëgjonin me vëmendje, kur u rrëfente, në Katund rreth emrit tim Kalosh. E pagëzova me këtë emër që të bëhet trim si Kaçaku i Maleve - Kalosh Zajazi. Vetëm se, ky ende nuk u bë trim edhe sot e kësaj dite në Qytetin e Qyqeve.

Vitet ikën njëri pas tjetrit dhe Babai një ditë u shpërngul me shtëpi rrëzë Çukës. Dëshira që unë të bëhem trim iu plotësua në atë jetë.

Tashti, mund të flejë i qetë Nesër mes varreve. Luftën që e nisi Kalosh Zajazi me pushkë, unë e vazhdova me penë...

Vallë, edhe çka mund të shkretoj mes këtyre rreshtave, faqeve, Libri për Nesër?! Asgjë. Larg kontejnierëve të bërllokut, larg Rrospive Meshkuj, larg marrëzërave. Megjithatë, vetëm në një Shkretirë të këtyre vazhdon të shkruhet ky liber për Nesër.

Zoti më ndihmoftë!... Amen...

1 Trokitja e papritur në derë më zgjoi nga gjumi. E di, se: nuk është Ajo, "E përcolla Natën". Zgjohem. E hap derën. Është Shërbyesja e hotelit.

- Zotëri, keni nevojë edhe për diçka?

- Jo, i përgjigjem, për asgjë mes këtyre bërlloku.

E urrej Vetën, pse në këto çaste nuk jam as për një gotë raki rrushi. E hap dritaren dhe i bërtas Liqenit:

- O Liqe, jam i vetmuar! Përtej kufirit i çmendur... Nuk e di pse, më dukesh si një shtamë me verë. Nuk dua, se, po të dua për një natë të shterë me fund...

E di, ju do të thoni se, kaheerë ju kemi thënë: është i çmendur. E kanë pushtuar xhindet qysh në djep. Lyrekun natën e kanë hedhur duar më duar mbi çatia. Majë lisave. Nusja me pashterkë të kuqe e ka rrahur gjithë natën e gjatë deri në vdekje. Pak para mëngjesit e ka dhunuar dhe e ka hedhur si një leckë të përdorur pas dere.

Përsëri nuk besoni?! Vetën e paqit në qafë. Unë, vetëm mund t'ua hap derën. Dritaren e keni të hapur krah më krah. Oxhaku nuk ju duhet, se: nuk jeni fis kaçakësh. Frika u ka hyrë në bark... Frika... Frika... Frika...

Edhe ditën.

Edhe natën.

Mëngjesin me Diell në shtrat e keni larg me vite... Vite... Dhe, vite... Dielli e ka humbur rrugën pas Malit. Yjet nuk ju bëjnë dritë. Hëna i ka shti në një thes dhe i ka nxjerrë t'i shes "toptan" në "Bit-Pazar"..

E këtyre marrëzive, askush nuk u beson, përveç Gruas sime besnike me dy shamia lidhur për brezi. Ajo para se të më përcjellë në Shpellë, në Shtëpinë Publike, më tha: të kanë bërë magji që të të duket e ftohtë Shtëpia... Gruaja... Fëmijët... Vështirë e kam të gjej ndonjë hoxhë me nam për hajmali. Yt At i provoi të gjithë hoxhallarët në Kërçovë. Edhe, në Gostivar. Tetovë e Shkup. Edhe Nëna yte, nuk la mollë e dardhë pa larë nëpër hoxhallarët e dëgjuar që kishin studjuar edhe në Kajro e kishin doktoruar atje, në mesin e librave, afër "Allahut". Ditë për ditë, njëri pas tjetrit hiqnin dorë. Nuk e zënë dot, thanë më në fund me inatë. Nuk lamë hajmali pa i varë përqafe. Ndonjëra, i zvarritej si këmborë dashi edhe deri në fund të këmbëve, po kot. Të gjorët prindër, sa të patën dashur, dhe hoqën gjithë jetën me ty duke të shkruar hajmali nëpër hoxhallarë. Fallxhësia duke të shkruarë plumb në një enë me ujë me eshtra të vdekurish. Vetëm, unë nuk heq dorë, më tha Gruaja ime besnike me dy shamia lidhur për brezi. Edhe pse, kohën e fundit e ke "mik" Hoxhën e Shkupit me pantollona të shkurtëra. Dhe, flitet me të madhe në Shtëpinë Publike se ty nuk të zë asnjë hajmali. Përinat, unë do të ta bëj një dhe do të ta varë përqafe deri në fund të këmbëve. Dhashtë Zoti, edhe kjo nuk të zë, vetëm pak besoj në një gjë të këtillë mes "Bit-Pazarit". E kam kënduar te Xhamia e madhe, te një kryehoxhë që është i njohur si shërues i grave shterpa anë e mbanë Atdheut...

E ke kot oj grua, i them me ironi. Habitem sesi, nuk të mbushet medja se mua nuk më zënë hajmalitë e hoxhallarëve, po të grave besnike. Megjithatë, të forta janë ato sukuj nën jastëk. Një Zot e di se, ku i kanë futur në shtrat, te hambarët, në mesin e librave, apo nën pragun e Shtëpisë. Hoxhallarët e provuan veten, nuk lanë Kuran e Divan pa çfletuar nëpër raftë. Kërkimet e tyre përfunduan me nga një hajmali ose, mollë të kuqe. Radhën, siç duket tashti e ka ndonjë Hoxhicë. Vetëm ajo ndodh të m'i përzë xhindet, të më shpëtojë nga magjitë...

- Hi-hi-hiii... Mikja me ferexhe... Qeshi Gruaja ime besnike me dy shamia lidhur për brezi. Megjithatë, unë si duket me siguri një ditë do të t'i përzë magjitë matanë pragut...

2 Natë. Matanë mureve më thërret Nusja me pashterkë të kuqe. E hap dritaren: Errësiirë. Nën hijen e ftoit e pash duke i rënë dajres me të dyja duart. Ebu Xha Ferri e hiqte vallen me shami. E valonte shaminë e kuqe e i përdridhte bythët. Belin.

- Ec, zbrit poshtë! Çka më shikon si mëzat i tredhur. Nuk ke frikë se, po të hipa lartë në verandë do të të shkepi çotek deri në mëngjes...

- Oh, jo. Jo, mezi iu përgjegja nga dritarja, mes grilave. E kam frikë pashterkën tënde të kuqe, Nuses pashterkuqe me pala. Shpeshëherë e shoh edhe në ëndërr, pasmesnate. Ja, zbrita menjëherë poshtë në lëmë. Aman, vetëm mos më rrah deri në mëngjes!...

E hoqa shulin e Derës Madhe të lisit, dhe e hapa derën. Nusja me pashterkë të kuqe më rrëmbeu përkrahu plot inatë.

- Ja, i tha Ebu Xha Ferrit. Është shkrimtar i krisur, merre dhe mos e lësho deri në mëngjes pa ia dhanë mirë hakun në shtrat. Ki, kujdes se, është i rrezikshëm, ndodh të të ikë nga dritarja, marrë malet, përtej Sharrit Palak.

O Imzot, thash në vete. U mplaka e nuk më kishte zënë syri deri më sot kësi rrospie. Bythët na, palare. Fytyrën rrumbullake. Faqekuqe si mështjerrë katundi, siç din Zoti më t'i krijojë rrospitë meshkuj...

- Ec pas meje, më tha Ebu Xha Ferri. Më rroku për dore dhe më tërhoqi zvarrë. Nusja me pashterkë të kuqe i ra dajres.

Ding - diing - diiing...

Rranka - ka - ka - kënk...

Ebu Xha Ferri duke kënduar e hequr vallen:

Do të mi japësh shtëllungat e leshit?...

Do të t'i jap moj Nuse si s'ti jape - jooo...

Dera u hap dhe unë ende pa e marrë veten, kur u ndezën dritat, mu këputën këmbët. Plot pas një ore e gjeta veten para Shtëpisë Publike. E ngrita kokën. E pash Ebu Xha Ferrin sesi ma bënte me gisht. E tërhoqa veten zvarrë dhe e pështyva në fytyrë. Ti nuk di t'i biesh dajres. Ti nuk di ta heqish vallen. Ti nuk di këngë...

Qeshi. Vallen e heq Nusja me pashterkë të kuqe. Ajo i bie edhe dajres. Edhe këndon këngë...

- E si e pate emrin zonjë?

- Unë jam Ebu Xha Ferri...

E mora janxhëkun me eshtra në krah dhe ika si pa kokë nga sytë - këmbët. Nëntë orë kisha ikur nëpër një pyll të dendur me lisa. Matanë përronit e pash F. B. me "*Filxhanin e dashurisë*". E kishte hapur në mes Librin dhe lexonte një poezi për Zehranë... Nusen e Shkupit pa duvak e koçi...

- Hë, më bërtiti me sa zë që kishte. Kush të turret pas shpine?

- Rrospitë Meshkuj! Mezi arrita t'i përgjigjem duke u mbushur frymë.

- E kam ditur se, vështirë e ke t'u shpëtosh nga duart... Grushtat... E kanë në dorë gjithë Shtëpinë Publike. Cilit t'ia vënë mëndjen e shtinë në dorë. E blejnë për pak para. Ose, e shesin në ndonjë ministri... Redaksi... Kabinet... Kujdes duhet patur, që mos të të takojnë natën në rrugë. Vaj halli nëse të zunë pas mesnate, prite nesër veten ministër, drejtor shkolle ose redaktor në ndonjë redaksi. Janë Rrospitë më të rrezikshme deri më sot që kanë lindur në Shtëpinë Publike. E heqin veten patriotë. Mendojnë se edhe kështu i dalin zot Atdheut...

Dhjetë ditë e dhjetë netë ika nga Qyteti i qyqeve dhe e strehova veten në Shtëpinë Publike. Natën vonë, pasmesnate e hapa dritaren. Matanë mureve errësirë. Nëpër Liqe më vinte një dritë. E zgjata dorën. Larg. Dikur, i dëshpruar u ktheva dhe u shtriva në shtratin me brymë. E arratisa veten mes mureve. Dallgëve që e rrihnin bregun. Hënën që mbyteshte në Liqe. Varkën me të cilën Ajo do të ktheheshte në

Vendlindje. Ëndërr. Lasgushi dhe Meri vinin drejtë meje nëpër Liqen. Aty për aty mu kujtua poezia "E mora shoqezën përkrah". Liqeni dhe "Hapat ca nga ca..." Vallë, ç'pa Liqeni?! Nuk e di. Ngadalë u ngrita edhe njëherë dhe e hapa dritaren krah më krah. Dielli më hyri në dhomë...

3 Dita si një nuse e bukur me pashterkën e kueqe deri në fund të këmbëve, zbriti në Liqe. Matanë maleve dyndeshte një mjegull. E tërhiqte veten zvarrë dhe mundoheshte ta shqepë mëngën e setres me arna, që me siguri i kishte ngecur në ndonjë lis. Kësulën e bardhë e kishte në kokë. E tërhiqte veten. E tërhiqte. E dinte se në një përrua do të pi ujë...

Hë?! Frikë keni se, mund të shti rrufeja. Hiqeni nga mendët! Qielli është i pastërt lot. Nuk shtin rrufeja në ferra. Jo. E lisat nuk e ulin kokën. Rrënjët i kanë shti thellë me vite e vite. Nuk ka kush që i shkul nga Sharri Plak... Korabi... Çelvjollca... Drenova... Baba Tomorri... Verë e dimër e kanë hapur gjoksin. Vetëm, një gjë e kam borxh t'ua them, mos ua shpaloni plagët!... E them këtë se, mund të rebelohen nga dhëmbjet. Shkunden nga dëbora... ta pushtojnë qiellin, kur ende është herët për këngë. E diellin e kemi larg... Larg... Larg...

Nuk do të dinë në cilën lëndinë t'i pushojnë degët. Me cilët zogjë...

Përsëri doni të më vëni në gjumë. E hiqni veten si një Nënëmadhe. E përkundëni djepin me shqiponjë mbi kokë. E këndonin një ninullë:

*"Nina nana po të përkundi
do të të bëj nana plak katundi..."*

E dini çka? Nuk më merr gjumi. Djepi po ma vret shpinën. E kam bërë edhe shurrën... Mutin... Më zgjidhni nga pelenat!... Djepi... Vetëm pak t'i lëviz duart, këmbët. Vetëm pak të shpëtoj nga ninulat... Përkundjet... Ëndërrat e tmerrshme që më rrinë nateditë mbi kokë. Atëherë, do të shihni si do ta thej zgjedhën. Nuk do ta tërheq qerren nëpër "Bit-Pazar"...

Ec pas meje, më tërhoqi me forcë Ebu Xha Ferri. Ti e ke humbur rrugën. Nuk e di në cilën dhomë ti kanë shti magjitë. E ke rënduar veten me mëkate. Njëqind ditë duhet larë në një kusi me ujë shkul (valë). E di, ti do një fuçi me verë. Aty brenda ta kesh edhe një Mike. Vetëm, nuk i meriton gjithë këto shpërblime. E ke ende zgjedhën në qafë. Për samarin dihet, as edhe përpiqesh që ta heqish nga shpina. Edhe në varr do të hysh, po i ngushtë është varri. Nuk të zë me gjithë samar. Jo.

E di çka, i them: samari nuk ma vret shpinën. E kam grepin në gojë me të cilin më tërheqin dhiareve. Nuk besoni? Pse, atëherë nuk e hudhni samarin?! Nuk e coptoni frerin. Nuk e thyeni zgjedhën?!... Trembeni nga samarë të rinj?!... Frerë... Zgjedha... O Imzot, si më ikët me të katra nga libri i "rrezikshëm"! Po, ç'të bëj unë pa ju mes këtyre bërthoqeve në "Bit – Pazar"? Asgjë. Jo. Jo, nuk mundem edhe unë pa ju. Patjetër, duhet ta shkruajmë Librin e "rrezikshëm" për Ditën e Nesërme.

Nata më zuri në një faqe. E thirra në ndihmë "E përcolla Natën". Ebu Xha Ferri më trokiti në xham. E ke kot: me mua do ta shkruash Librin për Nesër. Jo, më kërcnohet Shtirgani i Allahut, me mua! E kam këmbën e mbarë në xhami. Bythën e shpërlarë. Mjekarën si të Dexhallit. Po, mua më duhet penë!... Penë... E jo bythë si palare për të shkruar libër...

*Çudi, si s'e kemi ditur
se Patrioti lind.
Edhe atë, jo në vathë,
ose në Shtëpi Publike.
Po në odë të burrave.*

*E këndeje gjithë jetën
m'i keni shkërdhyer trutë
me vepra "patriotike".
Aqsa, më vjen t'ua pëshurrë
në Shtëpinë Publike...*

E hapta derën, në dhomë nuk më hyri njeri i gjallë. Dritaren kam frikë ta hap lumë miku. Frikë. Oxhakun e kam të hapur se, jam fis kaçaku. Nëse ua mba, ecni kur të doni me shokë!...

Dera është e hapur edhe për mikun edhe për armikun... Oxhaku për kaçakun... Kullën e kemi edhe për luftë. Vjet për vjet na e kanë djegur shkumb e hi, rrafshuar me tokë. Por, pas çdo djegëje e kemi ngritur përsëri edhe më të fortë. Edhe me më shumë frenxhi... Mes këtyre maleve dimërat janë të egër. E ngrijnë çatinë me akull. E përplasnin derën. Tymin na e kthejnë prapë në vatër... Përpiqen të na e rrëzojnë oxhakun...

Vetëm, oxhaku ynë gjithmonë tymon drejtë qiellit. Dollapët flakë. Trojet tona i ka shkelur Mbreti... Krali... U kemi dalë para edhe me sakica... Gërshtë të dhenëve... Mauzerre...

Nuk trembem unë nga këto këngë patriotike me çifteli, tha Buça e Katundit. Ec pas meje t'i dalësh zot Atdheut me ilahi! Nuk e sheh se po hyn në varr pa din e iman. Ku i ke sytë? Ku i ke këmbët? Duart?! Trutë nuk të duhen në kokë. Hë, çka nuk të pëlqen? Apo nuk ta mban si njeri i kalemmit? Fis i kaçakëve... Nuk je i vetdijshëm se më shurdhove më me atë Mike. Edhe me rakinë e rrushit... Verën... Rrapin... Vendin e ke në Xhehenem. Edhe atë, si arnë kazani... Rrapin duhet prerë me gjithë rrënjë!...

Hi-hi-hiii... Po, nuk keni sëpatë... Ju mendoni se gjithëmonë do të jetë Verë... Po, çka do të bëni në Dimër... Nuk e kam thënë Unë, e ke thënë Xha Deralla. Punë e lehtë, do të të kërkojmë ty një kaci shpuzë. Zjarrë?! Jo, nuk u jap zjarr. Jo. Rrini në Xhehenet...

4 E mora Vetën në shëpinë dhe e nxora matanë lumit. Ngadalë e shkarkova nën një shëlg. Njerën dorë ia qita nën kokë. Tjetrën, në brez. Një natë e një ditë fjeta nën qiellin e hapur. Të nesërmen, u ngrita dhe iu kacavjerra Rrapit. Në majë e hoqa setren dhe i futa edhe një sy gjumë. Pasmesdite, përsëri u shtriva nën hije. E nxorra një copë bukë nga janxhëku me arna. Edhe një copë djathi që ma kishin dhënë çobanët e Sharrit ta kem rrugës. E mbusha plot barkun si lodër. Matanë rrugës e pash Nusen me pashterkë të kuqe se si e tërhiqte veten zvarrë nëpër sokaqet e "Bit - Pazarit". Ebu Xha Ferrin nuk e kishte me vete, me siguri e kishin rrokullisur në ndonjë shtrat të Shtëpisë Publike. Nuk prish punë, e kishte me vete Haxhicën. E tërhiqte pas vetes, ku ta di unë në ndonjë xhami. Hoxha i priste para dere...

Ruana Zot!... Amin!...

*Nëna ime e ndjerë
e zgjidhte edhe Dashin*

për kopenë nga soji.

*E unë, edhe sot nën Rrap
e kam vështirë ta zgjedh Miken.
Që, ma pjellë Buça në lëmë
e ma ndërren pas shpine
të lehi tinëz Atdheut...*

- Eh, ore burrë ta dish sa të dua?! Natën shpeshëherë zgjohem nga gjumi dhe shoh a merr frymë.

- E po mirë, oj grua. Edhe, Unë të dua...

- E di. E di, ama unë të dua më shumë...

- Megjithatë, edhe Unë të dua...

- Eh, si jeni edhe ju burrat e Çukës. Vështirë u besoni grave besnike...

- Jo, oj grua. Unë nuk jam si burrat tjerë...

- Budallai. Mos do të thuash se je me brekë mbi pantollona...

- Jo, pa brekë...

- Hi-hi-hiii...

Burri i botës nuk priti më, po u ngritë dhe e rrëzoi në qilimin me këmbë arushe. E paloi sa gjërë gjatë dhe e bëri bythekrye. E rrotulloi në një krah dhe nga prapa duke u mbajtur me të dy duart për dy shtamave me vegë, që të mos rrëzohet në kokërr të shpinës, e këputi në mes. Çudi, si nuk i mbeti në dorë. Edhe njëherë e rrotulloi në krahun tjetër dhe e përmblodhi si bujku pllugin në arë. Dhe, atëherë kur i hudhi hebet në krah, donte ta flukë farën... Në dhomë ra tërmet. Oh, ooh, ooh... më fortë... më foortë... më fooortë... Edhe pak... Edhe paak... Edhe paaak... më pëshpërit në vesh... Oooh, ashtu... ashtu... ashtuuu... Dikur filloi t'i hajë çarshafët me dhëmbë... Përdridhet si bollë shullani... U çmendë...

Pasmesnate, e hipa para Gjokut dhe fluturova mbi Liqe. Matanë shtatë maleve e zbrita në tokë. E kaluam Lumin dhe pranë një burimi u ulëm nën Rrap. E nxora shtamën me verë dhe pasi e ngrita me fund u shtriva për një sy gjumë.

Të nesërmen, e vazhduam rrugën Grykës së Radikës. Nën një mal e rrokën xhindet dhe nuk e lëshuna deri në Shkup. Përpak, mes maleve desh e lash vetëm si qyqe... Vulli nga inati në mes të rrugës...

Edhe njëherë e shaluam Gjokun, dhe dikur para agimit, kur Qyteti i Qyqeve ende kotej në enëdr, mu në hyrje të "Sarajit" bëmë paqë. U dorëzua. E thirri edhe njëherë Natën. Edhe njëherë u çmendë... E pushtuam Shkupin pak para se t'i dalë gjumi...

O Imzot, pas dy netëve të çmendura u arratisë në një xhami dhe që andej nga minarja fluturoi në qiell. E di se nuk do të më besoni, kur do t'ju them se një ditë do të kthehet nën Rrap, në "Bit – Pazar". Përsëri do të pimë verë e do ta zbres armën nga dega. Fishekun do t'ia shti në gojë e do t'i vë pusi Ujkeshës...

*Të mjerët.
Thonë se, më iku Mikja
e nuk e dinë se Ajo është
me mua edhe përtej Vdekjes.*

Të mjerët.

*Thonë se, kam mbetur vetëm
e nuk e dinë se mua
më pëlqen Vetmia...*

Eh, ore burrë ta dish sa të dua!... Edhe nata pa ty më duket e zbrazët...

- Mirë, oj grua... Mirë... Gëzohem... E di... Megjithatë!... Edhe unë të dua!...

- Jo. Jo, ti nuk më do sa të dua unë...

Burrit më i erdhi deri në fyt kjo dashuri. Vendosi ta provojë dashurinë e gruas. Një ditë u shtri në shtrat.

- Oh, vdiqa... Oj grua, vdiqa... Vdiqa...

Gruaja filloi të qajë... Derdhi lotë mbi shtrat...

- Aman, or burrë, mos vdis këtë ditë! Ç`do të bëj unë e mjera pa ty, kërcuna. Oh, qyqja unë e mjera ç`më gjeti, dhe filloi ta gërvish fytyrën me thonj... Shkuli flokët...

Dhe, burri vdiq...

Atë ditë në kojshi bëhej një dasëm e madhe me shtatë palë lodra. Cingana. Gruaja si merakçije që ishte, vendosi të shkojë në dasëm, po kujt t`ia lente xhenazen. Iu kujtua, e thirri një plakë dhe u bënë pazar për dy shtëllunga leshi...

Gruaja shkoi në dasëm, ndërsa plaka e ruante xhenazen. Dikur, plakës nuk e di se si i ikën sytë në tavan. E pa një pastërmë. E mori një shkam dhe hipi të pres me thikë një copë. Po, i rrëshqiti shkami dhe bythekrye u rrëzua mbi xhenaze.

Tëëërrt... Pordhi xhenazja...

Plaka u tremb. Vallë, a pordhë xhenazja?! Patjetër, do të shkoj ta pyes Nusën. Nusja në atë moment e hiqte vallen dhe këndonte këngë. Plaka iu afrua ngadalë dhe i pëshpëriti në vesh:

- Nuse, a pordhë xhenazja?!

Nusja duke e hequr vallen me shami dhe vazhduar këngën iu përgjigj:

*Pordhë moj nane
si nuk pordhe - ooo...*

Plaka, pasi u sigurua, u kthye përsëri te xhenazja. E preu edhe një copë pastërmë. Dyshimi përsëri iu ngatërrua në kokë. Nuk ishte e sigurtë me shtëllungat e leshit. Ndodhë, Nusja të më mashtrojë, nuk do t`mi japi shtëllungat si shpërblim. Edhe njëherë vendosi të shkojë ta pyesë mes grave në valle me dajre.

Nusja ende e hiqte vallen dhe këngën. Plaka ngadalë i tha te veshi:

- Nuse, po shtëllungat e leshit a do t`mi japësh pas Dasmës madhe në katund?

*Në t`i jape, moj nane
si s`ti jape - ooo...*

Dasma mori fund. Nusja u kthye në shtëpi. Plaka i mori shtëllungat e leshit. Po, xhenazja që pordhi?! Eh, xhenazja që pordhi u ngrit dhe e përqafoi gruan. Hë, çka nuk e keni të qartë?! Gruaja, vërtetë e kishte dashur burrin. Edhe ju, nëse nuk u besoni grave, provoni të vdisni një ditë. Frikë keni mos u shkojnë gratë në dasëm, ë? Punë e madhe, le ta heqin vallen. Copë - copë le t`i bëjnë dajret. Gjithë natën e gjatë le të këndojnë këngë. Xhenazet tuaja ndoshta nuk pordhin... Hi-hi-hiii...

5 Natë. Matanë dritareve errët... Errët... Errët... Errët... Shiu pikon mbi çati. Mërzi... Bërllok... E urrej ditën. Natën. Përpiqem t'i vjellë gjithë ato vjet përpara këmbëve të mia. Vrapime... Rënje... Ngritje... Ndërsime... Vdekje... Dashuri... Tradhëti... I fus edhe dy gishtat në gojë... Fatkeqësisht, sonte dua të të vjellë edhe Ty me gjithë zorrë... Mjaft më m'i grive zorrët... Ngatërrove trutë... Pasmesnate m'i çmende poezitë... Shtamat me verë m'i rrëmbeve nga duart... I hodhe për dritare, bythekrye në lëmë. Rrapin do të ma shkulish me gjithë rrënjë. Degët ia përkul përtokë. Majën. E di, do të të lidh për gardhi. Zërin të ta dëgjojn shtatë katunde... Fajin e ke vetë, që më detyron të të shpie edhe te Hoxha. Një hajmali të madhe të ta var përqafe deri në fund të këmbëve. Natë e ditë të t'i përzë magjitë... Xhindet që të kanë mbështjellë lyrek në ferexhe. Pasmesnate që të dhunojnë mbi libra. Po. Hajmalitë e Hoxhës Ty mund të të shpëtojnë nga magjitë... Xhindet... Hajmalitë... Vetëm, jo edhe nga Baba Shehu që në Tyrbe ta hudhë ferexhenë e zezë mbi kokë. E heq dollamën. Shtatë herë me radhë të bën të sillesh rrotull varrit. E t'i lutesh të të bëj fëmijë... Të t'i prish magjitë... Përzë xhindet që t'i dhunojnë trutë... Ferexhenë e zezë të ta gris në Tyrbe. E dikur nga mëngjesi të të laj me verë. Hipi në Gjok e të marrë mallet. Rrugës t'ia thotë edhe një kënge.

Patjetër, duhet të ngjitet në Baba Tomor. Atdheun e perendive. Tyrben, ku pihet vera me shtama, shkruhet poezi... Dhe, bëhet dashuri...

E di çka, më tha Ebu Xhehli: të gjithëve në shkrime publicistike dhe libra na ke bërë rrospia. Vetëm nuk na i ke sharë edhe gratë besnike.

E vërtetë. Rrospia jeni... Rrospia... Gratë i keni mbi nivelin tuaj në këtë Shtëpi Publike. E juve, a ju vinte mirë kur i zgjidhni brekët. Natë për natë hynit e dilnit në Shtëpinë Publike. Policinë letrare të ma ndërsoni pas shpine. E nxirrni gjuhën nga vapa. I përdhridhni bythët te "Pazari Grave"... Nëpër "Bit - Pazar"...

Hi-hii-hiii...

- Nuk ka kuptim, tha Shtrigani i Allahut. Mysafirët i kemi ende këtu, e ju ziheni për Shtëpinë Publike. Nuk kemi shtet se, po ta kishim nuk do t'i shternin "patriotët" kuqezi herdhët...

- Kopilat, atëherë kush na i flukë para dere pasmesnate?... Kopilat?!...

- Nusja me pashterkë të kuqe...

- Rrospia... Rrospia, që na e mbushi Shtëpinë Publike me këlyshë me zgjebe...

- Kapeni, urdhëroi Ebu Xha Ferri! E dua të gjallë në Shtëpinë Publike. Është i rrezikshëm për Qytetin e Qyqeve. Ndodhë, të na e përhap SIDËN...

Tri Rrospitë Meshkuj më rrokën për këmbësh e duarsh dhe më hodhën bythekrye në Shtëpinë Publike. Derën ma hapi Hojdodolja. Shtrigani i Allahut më doli para me një qiri në dorë. Ec, pas meje më urdhëroi plot inat. Eca. Papritmas, më hodhën në Sallën e operacionit. E ndezën një llambë të madhe dhe ma afruan mbi kokë si saç. Trutë m'i shtinë në aparat.

- Simptome të tërbimit. Rrezik është ky i sëmurë të lëshohet në liri. Rrezik. Ndodhë, gjithë Shtëpinë Publike ta kaploj virusi i tërbimit. Njerëzit ta hanë njëri - tjetrin. Ose, t'i shterin herdhët te "Pazari Grave"...

Nëntë ditë e nëntë netë më sakatuan në Shtëpinë Publike. Trutë m'i nxorrën mbi tavolinë. U përpoqën të më shtinë tru këlyshi... Buçe... Qeni... E kotë. Kafka ime nuk pranonte organizëm të huaj mes eshtrave. Më në fund pas gjithë këtyre përpjekjeve u pajtuan që të m'i kthejnë përsëri trutë e mi në kokë. Edhe atë me një kusht: Që, çdo dy vjet përsëri të m'i nxjerrin mbi tavolinë për analiza policore...

Ditën e dhjetë dola nga Shtëpia Publike. E ngarkova Vetën në shpinë dhe u ula nën Rrap. E porosita një shtamë me verë. Matanë, Urës së Gurit e pash Ebu Xha Ferrin që më kishte përcjellur me trumbeta gjatë gjithë rrugës. E mjera rrospi mashkull, që dinte vetëm t'i përdredhi bythët nëpër "Bit - Pazar". Edhe atë, me mjeshtri nëpër Shtëpinë Publike. Nuk mu durua pa e përshëndetur me bërryl: naaa... Edhe pse, e dija se: matanë Vardarit përsëri do më vënte pusi...

Punemadhe. Rruga, gjithsesi duhet vazhduar për në Baba Tomorr me Tri Mike: Njëra të më pri para e Dy të tjerat të më mbajnë për krahu... Qoftë Ditë, qoftë Natë... Qoftë Verë, qoftë Dimër...

6 Mëngjes. E ngarkova Vetën në shpinë përmes sokaqeve me gurë deri te Rrap. Në një degë të tij sot kisha vendosur t'i varë armët. Në hijen e tij do ta lidhja Gjokun pullali. E dija se, më pret një luftë e përgjakur mes këtij bërlloku, që dita - ditës ma zente frymën. Vetëm, nuk e di pse ende nuk vinte Mikja të më jap gji nga ato dy shtama. Me siguri do të ma kthente fuqinë si Zanat e Malit Mujit e Halilit, që shtatë ditë e shtatë netë të mos i zbres Gjokut nga shpina. Shpatën ta ngrej lartë në dorë për Liri, rrotulloj në ajër. Shtatë ditë e shtatë netë të pi verë me shtama. Shtatë ditë e shtatë netë t'i shterë herdhjet në këtë Shtëpi Publike. Shtatë ditë e shtatë netë ta vazhdoj luftën me penë...

*Deven kur e kanë pyetur
kur e ke pasur më së vështiri
në jetë?
Është përgjigjur:
kur më ka pri gomari.*

*E mua po të më pyesni
në këtë Shtëpi Publike
do t'ju përgjigjem:
kur më pri Ebu Xha Ferri
me Shtriganin e Allahut
t'i dalim zot Atdheut
me çifteli e poezi patetike...*

Hi-hii-hiii... E kanë lidhur për Rrap si Krishtin... Miken ia kanë përzënë në Lindje... Ferexhen e zezë ia kanë hudhur mbi kokë mbi varrin e Baba Shehut... Natë e ditë kanë lenur lesh Arapi... E kanë vendosur, nën Rrap ta mbysin me verë...

- Heu, Dashnor Delia, pse fol sot, në mes të ditës kështu me vetveten?!

- Hi-hi-hiii... Më mirë të flas me vetveten se sa me Rrospitë Meshkuj. E kam frikë Nusën me pashterkë të kuqe... Frikë... Frikë... Nuk e di ti sa është ajo e rrezikshme në shtrat... Gjithë natën e gjatë kur të dhunon mbi çati... Majë lisave...

- Dashnor Delia, ngreja bythët në hava!...

- Hi-hii-hiii. E kam bërë moti planin. Vetëm, frikë kam se, në Ditën e sotshme ajo e para do t'mi ngrejë mua bythët në ndonjë livadh...

- Dashnor Delia, nuk e besoj, ti di t'a përdorësh trurin... Armën me dy tyta...

- Hi-hii-hiii... E di. Vetëm, atë shtrigë me ferexhenë hedhur krahëve, nuk e zë plumbi...
- Ooo Dashnor Delia, në mos e zëntë plumbi, do ta zë gjylja e topit...
- Hi-hii-hiii... E ke lehtë ti të flasësh ashtu, pasi ende nuk të ka shti në dorë... E kur të të shti në dorë, atëherë flasim si burrat... Po, t' i lëmë këto marrëzira, a do të ma qesësh një kafe?
- Jo, Dashnor Delia pa ia ngritur bythët Nuses me pashterkë të kuqe në hava...
 - E kam ditur moti. Mirë ta bënë Ebu Xha Ferri... Shtrigani i Allahut... Nusja me pashterkë të kuqe, që pasmesnate të hudhë dorë më dorë mbi çatia... Lisa...
 - Dashnor Delia, ia qëlllove me një plumb... Tashti e meriton një kafe... Porosite!...
 - Jo, nuk dua kafe nga ti, he burrë...
 - Dashnor Delia, pije një kafe!...
 - Jo, kafe ti pi me armiqtë, që gjithë ditën e gjithë natën bëjnë plane si të të vrasin nën Rrap, të të bëjnë atentat... Helmojnë... E di se, për ta e kam shkruar edhe një poezi...
 - Jo, Dashnor Delia. Gjithëçka kam ditur për ty, o trim mbi trima, po jo edhe se shkruan poezi erotike për Miken e shpërngulur në Turqi! Shkupi, të duket si Stambolli...
 - Eh, zoti Shkrimtar, këtu është gabimi... Hataja... Ti mendon se, vetëm ti di t' i shkruash Mikes poezi... E nuk e çanë kokën për poezitë e mia rebele, që i shkruaj rrugëve të "Bit-Pazarit", në Qytetin e Qyqeve...
 - Vërtetë, ke të drejtë Dashnor Delia. Po, lexoma njerën!... Edhe ashtu, moti nuk kam lexuar ndonjë vlerë të arrirë artistike...
 - Vetëm me një kusht. Që, të mos i tregosh askujt, njeriu të gjallë, se po mori vesh Nusja me pashterkë të kuqe do të më shkep dajak gjithë natën mbi çati...
 - Jo, or Dashnor Delia. Jo. Lexoje poezinë!...
 - Atëherë, hapi mirë veshët edhe sytë... Poezia është antologjike. Ndodhë DoktorZiu ta përfshijë në antologjinë e ardhshme të "Pazarit Grave"...

*Gjithë ditën - natën
bëjnë plane për atentat
me porosi të Kurvës Parti.
E shajnë e vrasin
nëpër çajtove e redaksi:
herë si patriot, herë si tradhëtar.*

*Të nesërmen, nën Rrap
me të hanë e pinë.
Vallë, athua hoqën dorë
apo nuk kanë armë...*

- Hi-hi-hiii... A të pëlqeu vjersha?
- Nuk e di, Dashnor Delia... Nuk e di... Vendin në letërsi do t' ia caktojë DoktorZiu.
- E kam ditur se, nuk merr vesh nga vjershat. E për sa i përket DoktorZiut, ai duhet t' i ketë herdhjet na, si vorba deri në fund të këmbëve në përpilimin e antologjisë. Fatkeqësisht, herdhjet e tij janë sa të gjelit... E kupton tashti, ku qëndron arti... Vlerat e arrira letrare... Ja, edhe arsyeja pse gjithëmonë t' i kanë ndërsyer pas shpine Tun Batunët... Buçat e Katundit... Këlyshët me zgjebe... Hojdodolen... Shtamat e tyre plot verë të kanë stimuluar për vepra artistike... Luftë...
 - E zgjova veten nga gjumi. Nuk e kisha ditur se kaq gjatë kisha pare ëndërr. E mora kokën mes grushtave dhe e shtrydha si copë djathi... E shtrydha mes këtij*

libri me të dyja duart... Litarë filluan të më rrjedhin mendimet... Vargjet... Poezitë... Libra e libra më dilnin nga koka. E tërhiqnin njeri - tjetrin për dore në bibliotekë. Vallë. Kush do t'i lexonte gjithë këto marrëzira... Njerëzit kanë nevojë për bukë... Verë... Dashuri... Liri... Kush e çan sot kokën për libra?!... Poezi kanë shkruar të marrët... Bohemët... Omar Khajami... Mirko Gashi... Frederik Rreshpja... Pano Taçi... Fadil Bekteshi... Gani Xhafolli... Të mençurit kanë bërë politikë "madhore"... E kanë shtuar pasurinë... E kanë dashur Atdheun... I kanë dalur zot me çifteli... Allti... I kanë përdredhur buthët na, si palare në Shtëpinë Publike...

7 Pasmesnate, dikur vonë nga mëngjesi, ma prishën gjumin me telefon. E kisha vështirë të ngritem nga shtrati, ngase vonë, shumë vonë kisha rënë në gjumë. Pesë vjet me radhë e shkruaja një roman dhe ende nuk e dija si do ta përfundoj dyluftimin. Symëshelë e ngrita kufjen.

- Zgjohu, ta bësh shurrën! U dëgjua zëri i një burri matanë telit.
- Falemnderit. Po, ec të ma mbajsh!...
- Kurvar, e pse nuk e pranon se ke fjetur me gruan time në hotel?...
- Ngase, nuk kam fjetur...
- E ke kot të më bindësh. E di unë edhe në cilin hotel... E di ti se, unë atë e kam dashur...

Shpirtin ma ke djegur për së gjalli...

- Jo, nuk e di. E di se, unë nuk kam fjetur me gruan tënde... Është rrenë e kurdisur...

- E di ti, ore i poshtër se mua s'ka çka më bën edhe policia... Afat ke, brenda një muaji me gjithë plaçka ta braktisësh Shkupin!...

- Kurrë! E ti, a e di se unë deri më tash kam qi gra, e që sonte do të filloj të qi edhe burra... Edhe atë me ty do ta filloj të parin...

E përplasa kufjen dhe ia mbylla telefonin. E pata të qartë se nga më vinin këto kërcnime. Gati të gjitha metodat i kishin përdorur, u kishte mbetur edhe e fundit. Librat e mi me satira si duket e kishin bërë të veten, m'i kishin ndërsyer tinëz personazhet e librave të mi. E unë për ta isha në gjendje ta jap edhe jetën. Merreni me mend sa i kam dashur, e shi tashti ata ishin në gjendje të më përzënë nga Atdheu. Ose, të më vrasin nën Rrap. Edhe atë një qëllim: të më ndanin me dhunë nga personazhet e mi, që unë gati me ta e kisha jetuar gjysmën e jetës. Vallë, a u shkonte ndonjëherë mendja se, a do t'i donte dikush më shumë se unë? Vërtetë, ata më urrejnë, po unë i dua... I dua... Po, të mos ishin ata, edhe unë nuk do të isha si shkrimtar. Vaj halli, nëse ndonjëri ku ta di unë, nesër e len grua. Vdes në shtrat. Ose e shkel treni... Kamioni... Ose bën vetvrasje... Po, a e dini ju se, unë personazhet e mi jam në gjendje t'i vajtoj gjithë ditën... Natën... Gjithë jetën... O Imzot, sa shumë i dua hadumët!...

Fragment nga Romani: SHTËPIA PUBLIKE (Shkup - Prishtinë, 2000, 2015).